



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA

KOSOVA CUMHURİYETİ

Komuna e Prizrenit * Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 663/25 Dt. 31.12.2025

PLANI I KONSULTIMEVE PUBLIKE ME QYTETARË PËR VITIN 2026

Plani i Konsultimeve Publike për vitit 2026

Duke u bazuar në nenin 20 pika 1, 2, 3 dhe 4-ter e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna e Prizrenit ka përgatitur planin e dokumenteve të cilat do të dalin në konsultim publik me qytetarë, OJQ-ë dhe palë tjera relevante.

Plani parasheh njoftimin me kohë të qytetareve, organizatave të shoqërisë civile si dhe organizatat ndërkombëtare për procedurat e hartimit të dokumenteve komunale, vendin dhe kohën e konsultimeve.

Konsultimet publike organizohen nga Njesisë për Komunikim me Publikun, zyrtari përgjegjës për konsultime publike, drejtoritë komunale dhe iniciuesit tjerë eventual për hartim të ndonjë dokumenti.

Për secilin konsultim publik do të mbahet procesverbali dhe në përmbyllje të konsultimit hartohet raporti përfundimtar. Procesverbali dhe raporti publikohen në ueb faqe zyrtare si dhe në platformën e konsultimeve publike.

Plani i Konsultimeve Publike për vitin 2026 përbën dokumentin udhëzues për organizimin, zhvillimin dhe monitorimin e proceseve konsultuese midis Komunës së Prizrenit dhe publikut të gjerë. Ky plan ka për qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave lokale.

1. Qëllimi i Planit të Konsultimeve Publike

Qëllimi kryesor i planit është të sigurojë:

- Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të qytetarëve dhe palëve të interesit në proceset vendimmarrëse;
- Ngritje të transparencës institucionale dhe besimit të publikut;
- Përmirësim të cilësisë së dokumenteve strategjike dhe akteve komunale përmes kontributit qytetar;
- Harmonizim të praktikave të konsultimit me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna dhe dokumente tjera relevante.

2. Dokumentet dhe proceset që i nënshtrohen konsultimit publik

Plani përcakton listën e dokumenteve që obligohen të kalojnë në procedurë të konsultimit publik gjatë vitit 2026, përfshirë:

- Dokumentet strategjike afatgjata dhe afatmesme të Komunës;
- Planet dhe programet sektoriale të drejtorive përkatëse;
- Aktet rregullative dhe propozim-rregulloret komunale;

3. Parimet udhëheqëse të procesit të konsultimeve

Plani mbështetet në parimet:

- Transparencë-publikimi i të gjitha materialeve relevante para konsultimit;
- Përfshirje-mundësi e barabartë e pjesëmarrjes për qytetarët, OJQ-të, bizneset, rininë, komunitetet dhe palët tjera të interesit;
- bashkë autorësi-kontributet e qytetarëve merren në konsideratë gjatë finalizimit të dokumenteve;
- Llogaridhënie-përgjigje e qartë ndaj komenteve të pranuara dhe publikim i raporteve përfundimtare;
- Qartësi dhe aksesueshmëri-informacion i kuptueshëm, i plotë dhe i qasshëm për të gjithë të interesuarit.

4. Metodologjia e konsultimeve

Plani përcakton format dhe mjetet për realizimin e konsultimeve, si:

- Dëgjime publike fizike në lagje dhe zona administrative;
- Konsultime elektronike përmes platformës së konsultimeve publike;
- Takime të rregullta me Këshillat e Fshatrave dhe bashkësive lokale.

Metodologjia garanton që konsultimet të realizohen me kohë të mjaftueshme, me njoftim paraprak dhe dokumentacion të plotë të publikuar online.

5. Afatet kohore dhe kalendari vjetor

Plani përfshin një kalendar detajuar vjetor të konsultimeve ku përcaktohen:

- Muaji i publikimit të dokumentit;
- Afati i konsultimit publik (jo më pak se 15 ditë pune);
- Data e dëgjimeve publike;
- Drejtoria përgjegjëse dhe personi kontaktues;
- Afati i publikimit të raportit përfundimtar të konsultimit.

6. Roli dhe përgjegjësitë institucionale

Plani definon rolet e:

- Drejtorive komunale – përgatitja e dokumenteve dhe organizimi i konsultimeve;
- Zyrës për Informim dhe Transparencë-koordinimi, publikimi dhe raportimi;
- Kryetarit të Komunës-mbikëqyrja e zbatimit të politikave të konsultimit;
- Këshillit Komunal-shqyrtimi i dokumenteve pas fazës së konsultimit;
- Qytetarëve dhe organizatave-pjesëmarrja aktive dhe dorëzimi i komenteve.

Dokumentet që do të dalin në konsultim publik me qytetarë gjatë vitit 2026:

Nr	Përgjegjës për organizimin e konsultimit	Titulli i Dokumentit	Koha e fillimit të hartimit të dokumentit	Koha e pritshme për miratim të aktit në kuvend	Metodat tjera krahas me platformat online	Buxheti	Procesmbajtës/se me komunikimi me mediat
1	Kryesuesja e Kuvendit Drejtorja për Ekonomi dhe Financa Njësia për Komunikim me Publikun	Qarkorja e parë buxhetore (KAB-i)	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Qershor	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtorja/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
2	Zyra e kryetarit Drejtorja për Ekonomi dhe Financa Njësia për Komunikim me Publikun	Qarkorja e parë buxhetore (KAB-i)	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Qershor	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtorja/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
3	Zyra e Personelit	Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në komunën e Prizrenit	Mars Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Prill	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtorja/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi

4	Drejtoria e Inspektoratit	Rregullore për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike ne sektorin e gastronomisë	Mars Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Prill	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
5	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Korrik	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
6	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Themelimi i Organit të Kujdestarisë Obligativ sipas Ligjit ne fuqi	Mars 2026 Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Prill-Qershor	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
7	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Rivitalizimi i Planit Tre Vjeçar për Banim	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Qershor	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të		Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia i iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
8	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Hartimi i Statutit të Qendrës për Punë Sociale	Qershor 2026 Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Qershor	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
9	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Hartimi i planit komunal për fëmijët ne situata rruge 2026-2028	Qershor 2026 Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi

10	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Plani i veprimit komunal për strehim familjar 2025-2027	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
11	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Akthemelimi i institucionit Shtëpia e Përqendrimit	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
12	Drejtoria e Punës Mirëqenies Sociale Njësia-Qendra për punë sociale	Akthemelimi i institucionit Shtëpia rezidenciale	Qershor Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
13	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Plani 5 vjeçar për menaxhimin e mbeturinave	Janar Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
14	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Plani për biodiversitet	Janar Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
15	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Plani lokal i veprimit në mjedis	Janar Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi

16	Drejtoria Publike	Shërbimeve	Rregullore për menaxhimin e mbeturinave	Janar e Salla Mbledhjeve e Kuvendit Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
17	Drejtoria Komunale e Arsimit		Rregullore për Përdorimin e Teknologjisë dhe Sigurisë Digjitale në Shkollë	Mars-Qershor e Salla Mbledhjeve e Kuvendit Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Zani Vula Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
18	Drejtoria Komunale e Arsimit		Strategjia Komunale për Përfshirje dhe Mbështetje të Nxënësve me Nevoja të Veçanta	Qershor e Salla Mbledhjeve e Kuvendit Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Katrina Dakaj Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
19	Drejtoria Komunale e Arsimit		Plani Komunal për Talente dhe Ekselencë në Arsimit	Qershor e Salla Mbledhjeve e Kuvendit Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Isuf Kurtaj Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi
20	Drejtoria Komunale e Arsimit		Rregullore për Menaxhimin e Projekteve dhe Partneriteteve në Shkollë	Qershor e Salla Mbledhjeve e Kuvendit Komunës (Shtëpia e Bardhë)	Shtator	Publikimi në uebfaqe zyrtare të komunës Platformën e konsultimeve dhe takimeve me grupet e interesit dhe OJQ-të	Pa kosto	Zyrtari/ja që caktohet nga drejtoria/njësia iniciuese Nexhat Maçkaj Adelina Hoxhaj Haziz Krasniqi

Raportimi dhe monitorimi:

Plani parasheh monitorim të rregullt dhe publikim të:

- Raporteve për çdo konsultim publik të realizuar;
- Raportit vjetor të konsultimeve publike për vitin 2026;
- Indikatorëve të performancës për matjen e nivelit të pjesëmarrjes, transparencës dhe efektivitetit.

Përfundimi:

Plani i Konsultimeve Publike për vitin 2026 është instrument kyç për forcimin e demokracisë lokale në Komunën e Prizrenit. Ai siguron që qytetarët të jenë pjesë e proceseve vendimmarrëse, duke kontribuar në krijimin e politikave më cilësore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Plani i Konsultimeve Publike për vitin 2026, mund të ndryshoj varësisht nga kërkesat at-hoc që mund të vijnë nga kryetari i komunës, kryesuesja e kuvendit, drejtoritë/ zyrtarë komunale dhe kërkesat që mund të vijnë nga niveli qendrorë-qeveria, ministritë dhe palët të tjera eventuale.

Në konsultime publike mund të marrin pjesë :

Qytetarët, kryetarët/et e këshillave të lagjeve dhe fshatrave, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë/rejat, pensionistët/et, studentët/et, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Prizrenit, deputet/e, punonjësit e komunës, përfaqësuesit e partive politike dhe përfaqësuesit e mediave dhe palë të tjera të interesuara.

Komentet dhe sugjerimet e të gjithë të interesuarave që dëshirojnë të kontribuojnë në hartimin e këtyre dokumenteve mund ti dërgojnë në emailat: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net **si dhe në formë fizike në këtë adresë: Rruga Adem Jashari Nr 275 Prizren 20000 (Shtëpia e Bardhë).**

Përgjegjës për zbatimin e planit janë:

- 1.Kryetari i Komunës,
- 2.Kryesuesja e Kuvendit Komunal,
- 3.Drejtoritë e Drejtorive Komunale,
- 4.Njësitë/zyrat.


Dokumenti është i bazuar në planin e punës së kryetarit të komunës, planin e punës së kuvendit të komunës, drejtorive dhe njësive/zyrave tjera që planifikojnë të hartojnë dokumente gjatë vitit 2026.

Lajmet, njoftimet, thirrjet, ftesat, shpalljet dhe agjendat tjera zyrtare të komunës sonë i publikojmë me kohë dhe sipas kërkesave ligjore në webfaqe të komunës dhe platformat tjera sociale në shfrytëzim zyrtar.

Publikimet i gjeni edhe në vegëzën vijuese: <https://kk.rks-gov.net/prizren/lajmet/> . Në këtë vegëz: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/> , mund ti gjeni të publikuara sipas afateve ligjore, njoftimet, procesverbalet si dhe raportet për mbajtjen e konsultimeve publike.

Përgatiti:

Haziz Krasniqi



Zyrtar i Lartë për Informim dhe Raportim

Zyrtar përgjegjës për Konsultime Publike